



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**  
**DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Tiranë më, 03.02.2020

## NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në Vendimin nr. 47, datë 22.01.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

### I. DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE:

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 8h/ditë), kategoria IV-b

**Detyrat kryesore:** Kontrollon dhe vlerëson nga ana administrative dosjet e aplikantëve për të aprovuar ose jo aplikimet për programet me financim të huaj, duke zbatuar manualin e procedurave dhe udhëzimet përkatëse. Raporton parregullsitë e hasura gjatë procesit të punës. Ndjek kërkesat/ankesat e deleguara nga eprori lidhur me aplikantët që kanë aplikuar në skemat dhe programet me financim të huaj. Kryerja e nivelit të parë dhe të dytë të kontrolleve administrative të aplikimeve të masave.

#### **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Bujqësore, Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike, Shkenca Inxhinierike - UPT/ Shkencat e Natyrës. *(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
6. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale

#### **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së, për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD).
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar.

## II. PUNONJËS ARKIVE (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria VII

**Detyrat kryesore:** Ofron suport për mirëmbajtjen dhe organizimin e arkivës së institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe manualët përkatëse.

### **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë universitar, niveli Bachelor.
2. *(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).*
3. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
4. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

### **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat".
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës **06.02.2020**, ora **16:30** në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga "Muhamet Gjolleasha", Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**